



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Korrik, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Muhamet Pervetica, U.D. i udhëheqësit të Sektorit të shëndetësisë në DSH, Dr. Fatlinda Hoxha - zyrtare për shëndetësi në DSH.

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit korrik 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 38 lëndë nga të cilat 36 ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore kurse 2 tjera ishin të kategorive të ndryshme. Stafi në këtë drejtori, kishte takime të përditshme me qytetarë për tu njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative zbatimi i planprokurimit të v. 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Prezantohen gjetjet kryesore të tri hulumtimeve që Komuna e Prishtinës realizoi në lidhje me seroprevalencën me sëmundjen COVID – 19 në Prishtinë.

Tek hulumtimi në lidhje me seroprevalencën e qytetarëve, rezultatet flasin për rreth 47% të qytetarëve të Prishtinës që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 qoftë me test serologjik apo CPR;

Ky hulumtim përfshin të dhënat e mbledhura përgjatë muajve maj – qershor 2021, dhe mostra e studimi ka përfshirë 1255 qytetarë;

Sa i përket hulumtimit rreth seroprevalencës së punonjësve shëndetësor në Komunën e Prishtinës, del se rreth 48% e tyre kanë qenë rezultuar pozitiv me COVID-19, qoftë përmes testit serologjik apo CPR;

Hulumtimi është realizuar përgjatë periudhës 14 tetor – 17 dhjetor 2020 dhe ka përfshirë një mostër prej 475 punëtorë shëndetësorë:

- Pacientët furnizohen me insulinë;
- Zhvillohet faza III e dezinfektimit hapësinor;
- Monitorohen punimet në punishten në rrugën “Kujtim Laro” të lagjes Veternik, ku po ndërtohet Qendra e parë e Mjekësisë Familjare për këtë zonë;
- Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare nisin për herë të parë edhe testet për hormone si: T3, T4, TSH, PSA;
- Ritenderohet aktiviteti - Furnizim me autovetura për shërbimet shëndetësore - RITENDER;
- Vazhdojnë të menaxhohen aktivitetet:
 - Furnizim me inventar për nevojat e institucioneve KPSH;
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve KPSH.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përgatitja e specifikave bazuar në plan prokurimi 2021;
- Mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

5.1.2. Takimet me palë

- Çdo dite nga ora 9:00 deri në orën 15:00, DSH bën pranimin e palëve;

5.1.3. Takimet me institucione të tjera

- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
 - o Menaxhim i kontratës “Renovime dhe rindërtime”;
- Drejtoria e Prokurimit:
Procedura rreth kontratave të ndryshme.

5.1.4. Diskutime publike, takime me qytetarë

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- 38 lëndë, nga të cilat 36 ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, kurse 2 tjera ishin të kategorive të ndryshme.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve

Më 16.07.2021, është mbajtur mbledhja e Komisionit për shqyrtimin e lëndëve në Drejtorinë e Shëndetësisë, ku janë shqyrtuar gjithsej 85 lëndë dhe janë miratuar. Po ashtu, janë përpiluar 104 vendime, gjithashtu është finalizuar lista e pagesave.

5.1.8. Takime të tjera

Drejtori i Shëndetësisë, dr. Bujar Gashi me qëllim të mbarëvajtjes së punës në sektorin e shëndetësisë në mënyrë të vazhdueshme realizoj takime me përfaqësuesit e QKMF-së dhe QMF-ve.

Në këto takime drejtori Gashi ka biseduar edhe për vështirësitë që kanë QKMF-të dhe njësitë e saj dhe QMU-të.

Drejtori i shëndetësisë së Prishtinës në agjendën e tij realizoi takime edhe me nivelin qendror, siç është Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të informimit dhe rritjes së efikasitetit në Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucione të ndryshme, ju lutëm i shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm, i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Hyrje

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit korrik 2021, ishte e angazhuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente për qytetarët e Prishtinës dhe fshatrave që i takojnë komunës me ekipe mjekësore dhe autoambulanca.

Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të urgjencës, kanë dominuar rastet me:

- Hipertension arterial;;

- Reaksinet alergjike;
- Gjendjet me kollabime;
- Gastroenterokolitet akute;
- Kokëdhimbjet akute;
- Diaret të shoqëruara me dehidrime;
- Ataquet cerebrovasculare
- Hipotensioni;
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut;
- Ataquet ischemike tranzitore;
- Lëndimet aksidentale, etj.

Sa i përket numrit të rasteve një raport i detajuar është përpiluar dhe dërguar në DSH, nga zyrtarja e SISH.

Furnizimi me medikamente dhe material sanitar

Furnizimi vazhdon nga Ministria e Shëndetsisë-divizioni farmaceutik dhe nga kompanit e kontraktuara prej Drejtorati i Shëndetësisë.

Janë plotësue nevojat e domosdoshme me medikamente dhe material sanitar.

Situata me pandeminë COVID-19

Duke përcjell situatën epidemiologjike gjatë muajit korrik, por edhe nga informatat nga IKSHP-ja, kemi një gjendje stabile me një rritje të rasteve me COVID-19, duke marr parasysh se ka dyshime për përhapjen e formës delta.

Gjatë këtij muaj, nga kolektivi nuk kemi pasur asnjë punëtor të infektuar me COVID-19. Gjatë këtij muaj një ekip mjekësor nga QMU-ja, ka vazhduar kujdestarit në sallën 1 Tetori për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat që kanë pasur nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore.

Nga ekipet mjekësore deri tani nuk është raportuar asnjë rast i komplikimeve postvaksinale, përveç nevojës për ndonjë këshill ose ndonjë ekzaminim si matje të shtypjes së gjakut, pulsit, saturimit të oksigjenit, matjes së sheqerit etj.

Nga aktivitetet kulturo - sportive

Me e daten 22.07.2021 ekipi mjekësor me autoambulancë ka aistuar në stervitjen e zhvilluar nga klubet futbollistike FC. Feynoord (Holand) dhe të FC Drita (Gjilan) të cilat janë mbajtur në Stadiumin Fadil Vokrri nga ora 18-30 deri në orën 21:30 h;

Po ashtu me daten 22.07.2021 është luajtur ndeshja zyrtare e vlefshme per kupen e UEFA-së, mes klubeve FC Drita dhe FC Feynoord, dy ekipe mjekësore kan asistuar prej orës 19:00 deri në orën 23:00h, gjethsej 4 ore;

Ndeshja është luajtur në stadiumin Fadil Vokrri, si në trening, dhe gjatë ndeshjes nuk ka pasur lëndime serioze dhe ekscese sipas raportit të ekipeve mjekësor;

Prej dates 15 korrik në sheshin "Zahir Pajazit,, është duke u zhvilluar aktiviteti Akull n'Veve, ku përgjatë 1 muaji prej datës 15 korrik deri me daten 15 gusht, një ambulance me ekip mjekësor është duke qëndruar në kët shesh me qellim të ofrimit të ndihmës urgjente qytetarëve në rast nevoje;

Aktiviteti është organizuar nga drejtoria e Kulturës së Komunes së Prishtines, ndërsa mbështetja nga QMU-ja është duke u bër me miratim të Drejtorisë së Shëndetësisë; Edhe në ket rast vlen për t'u theksuar se nuk kemi pasur raste të rënda mjekësore, ekipet po qendrojnë në shesh, prej orës 19:00 deri 24:00 h;

Nga Federata e Futbollit të Kosovës kemi pranuar kërkesën për mbështetje të turnirit futbollistik i cili ka filluar prej datës 08 korrik e që do të vazhdojë deri me datën 06. gusht; Turniri është duke u mbajtur në kampin e stervitjeve në Fshatin Hajvali dhe atë në dy termine në orët e paraditës nga ora 08:45 deri në orën 10:45 h dhe në mbrëmje nga ora 17:45 deri në orën 19:45;

Sipas raportimeve nga ekipet mjekësore deri tani kemi pasur vetëm një lëndim të rëndë të një futbollisti me datën 25.07 rreth orës 10:00, të njejtit në fushë i është ofruar ndihma mjekësore urgjente dhe është transportuar në Qendrën Emergjente për tretman spitalor; Të gjitha pjesëmarrjet e QMU-së, në këto evente kulturo-sportive kanë qenë të miratuara nga DSH-ja.

Këto kanë qenë angazhimet kryesore të stafit shëndetsor në punë dhe aktivitetet gjatë muajit korrik 2021.

RAPORTI I PËRMBLEDHUR PËR MUAJIN KORRIK I KORDINATORËS SË SISH -së, QMU-së

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1368
2	Reanimime në terren	4
3	Aksidente trafiku	90
5	Fatekeqësi të tjera	48
6	EKG	6
7	Transporte	268
8	Konstatim vdekjeje	42
9	Gjithsej	1830

ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësit kërkuese;
- Bashkëpunimi i zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA, 2016 të LPP me AQP për kycje në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranim të mallrave ,shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj.;
- Sipas nevojave të paraqitura.

❖ **AKTIVITETET E ZBATUARA**

- Nxjerrja e urdhër blerjeve në sistemin e FREE BALANCIT për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU-ja;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me ujë për pije dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për shërbime të fotokopjes dhe printerëve me qira dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me goma verore dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i të gjitha faturave tjera që kanë hyrë në QMU dhe përgatitja e tyre për pagesë;
- Vazhdim i procedurës furnizim me barna dhe material medicinal;
- Me 01.07.2021. hapja e ofertave për furnizim me barna dhe material medicinal;
- Vlerësimi i ofertës furnizim me barna dhe material medicinal;
- Njoftimi i vendimit të AK-ë për furnizim me barna dhe material medicinal si dhe punimi i letrave standarde për OE.
- Njoftimi për dhënie të kontratës, nënshkrimi i kontratës, njoftimi për nënshkrimin e kontratës për furnizim me barna dhe material medicinal;
- Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës dhe PMK;
- Furnizimi me barna, formimi i komisionit për pranim të barnave;
- Kompletimi i lëndës ,fotokopjimi, nxjerrja e UB dhe përgatitja për pagesë.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës.

ZYRA E FINANCAVE NË QMU

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Mbatja e një takimi me stafin udheheqës në lidhje me paraqitjen e kërkesave që kanë punëtorët për furnizime dhe shërbime për periudhen e ardhshme.

❖ **AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA**

- Përgatitja e lëndëve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre ;
- Shpenzimet e telefonit për muajin qershor;
- Shpenzimet e tel. në punktin e QMU-së ë QMF nr.4 (Xhemajl Ibish) për muajin qershor;
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin qershor;
- Furnizim me ujë për pije për muajin qershor;
- Shfrytëzimi i automjetit me qëra për muajin qershor;
- Furnizim me karburante për muajin qershor;
- Përgatitja e faturave për mirmbajtjen e autoambulancave;
- Ndërrimet e natës për muajin qershor;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj.për muajin qershor;
- Përgatitja e pagave për 5 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin qershor;
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2022;
- Përgatitja e raportit financiar të tre mujorit të dytë (TM-II).

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPER**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë;
- Fatura e rrymes ;
- Sigurimi i Autoambulancave ;
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve;
- Mbushje për punëtor për muajin korrik;
- Përgatitja e ndërrimeve për muajin korrik;
- Përgatitja e faturave komunale (rrymë ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera;
- Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e Paras së imtë;
- Faturat e lartë cekura janë të rregullta çdo muaj dhe duhet të kryhet përgatitja e tyre me të gjitha dokumentet përcjellse dhe të dërgohen në DSH.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm përshtatur me situatën epidemiologjike, mbi ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
 - Tre Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në orën 07:00);
 - Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare punuan me orar të rregullt (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00);
 - Në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 13:00);
 - Në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës janë punuar 386 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit ku janë punuar 761 D-dimera, që të dyja këto falas, po ashtu janë punuar edhe testet serologjike 97 pacient të testuar me teste serologjike. Pacient për T3,T4,TSH,dhe PSA gjithësejt janë 41;
 - Numri i pacientëve COVID-19 pozitiv që kanë kërkuar trajtim parenteral në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare ka arritur në 54 pacient;
 - Numri i konsultave virtuale gjatë muajit korrik ka arritur në 222 konsulta;
 - QMF Besi, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 13:30 deri në orën 20:00) organizohet dhe kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 13:00),AMF Bardhosh nga data 05.05.2021, është në renovim, AMF Barilevë, nuk punon, AMF-së Sharban dhe Rimanishtë orari i punës (07:00 deri në orën 14:00);
 - Llukar, orari i punës(07:00 deri në orën 14:00), AMF Keqekollë, orari i punës (08:00 deri në orën 14:00) të martën nuk punohet, AMF Koliq, punohet të martën nga ora (08:00 deri në 14:00), AMF Dabishevc, punohet të enjten nga ora (10:00 deri në orën 12:00);
 - AMF Mramor, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30) çdo ditë, AMF Slivovë, Viti, Bullaj nuk punohet, AMF Kishnicë, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30);
 - AMF Shkabaj, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30);
 - Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik, orari i punës(07:00 deri në orën 15:00), shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;
 - Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 dhe 13:30 deri në orën 20:00);
 - QMG, orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
 - Shërbimi specialistik, orari i punës (07:00 deri në orën15:00);
 - Mjekësia e punës, orari i punës (07:00 deri në orën15:00);

- DAT, orari i punës (07:00 deri në orën13:00);
- Laboratori qendror orari i punë(07:00 deri ne[orën 14:00 -13:00deri në orën 20:00);

-Radiologjia orari i punës (07:00deri në orën 13:00),tre njësi Radiologjike në QKMF,QMF4,QMF 5.

- Shërbimi i vaksinimit orari i punës(08:00 deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye se pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësor nga data 29/03/2021 janë duke kontribuar në sallën “1Tetori” rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID-19;

Janë duke funksionuar 30 ekipe të vaksinimit, në orarin paradite 15 dhe 15 ekipe të vaksinimit në orarin e pasdites;

Numri i të vaksinuarve për muajin korrik është 41.338 dhe numri total i të vaksinuarve nga data 29/03/2021 deri më 30/07/2021 është 76.041;

-Numri i stafit të infektuar gjatë muajit korrik vetëm një punëtor shëndetësor i infektuar;

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze;

- Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Viz. mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
96314	61880	59550	10635	2020	230399